



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar në datë 14.07.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-450



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**KOMUNA E SUHAREKËS
SUHAREKA MUNICIPALITY**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

DHE

KOMUNËS SË SUHAREKËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
14-07-2023			
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI - RECEIVED			
Organizata dhe titull	Nr. i Bid. Number	Shtesa Prig. Appendix	Vendi Vendi: Vendi
	01	016 44004	J

Neni 1

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) lidhet mes Komunës së Suharekës (në tekstin e mëtejme Komuna), e përfaqësuar nga Kryetari z. Bali Muharremaj dhe Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren (në tekstin e mëtejme Universiteti, përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

Komuna dhe Universiteti pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngrisin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen profesionale të studentëve.

Neni 4

Komuna dhe Universiteti së bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit e sektorit edukativ dhe profesional, ofrimin e shërbimeve përkatëse për këtë universitet, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë. Në këtë aspekt, Universiteti do t'i ofrojë ndihmë shkencore-profesionale Komunës me shërbimet e veta.

Neni 5

Komuna dhe Universiteti pajtohen që të bashkëpunojnë për hartimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social.

Neni 6

Komuna do të pranojnë në bazë të mundësive një numër të studentëve të Universitetit për të bërë praktikën profesionale nëpër zyrat e Komunës dhe institucioneve vartëse.

Neni 7

Komuna do të angazhohet që në bazë të mundësive të ofrojë bursa për studentët e Universitetit, atyre me gjendje të rënduar ekonomike, përfshirë edhe familjet e kategorive të dala nga lufta e fundit në Kosovë.

Neni 8

Komuna dhe Universiteti pajtohen që për nevoja të tyre të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Neni 9

Komuna dhe Universiteti pajtohen për shfrytëzimin e institucioneve dhe hapësirave komunale për studentët, stafin akademik dhe administrativ, si: Bibliotekës Komunale, Qendra Sportive, fushave sportive, institucionet kulturore komunale, etj..

Neni 10

Komuna do të mbështesë Universitetin në kuadër të mundësive në Organizimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

Neni 11

Komuna dhe Universiteti pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të planeve dhe dokumenteve strategjike të dy palëve.

Neni 12

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhë 5 (pesë) vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi dhe plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.

Neni 13

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Rektori:
Prof. Assoc. Dr. Mentor Alishani



Kryetari i Komunës:
Bafi Muhtarremaj



Prizren, Korrik 2023